

PROCESVERBAL
“I HEDHJES SË SHORTIT MANUAL”

I mbajtur sot me datë 11.12.2019 ora 18.40, nga sekretare Dorina Dulaj, në prani të:

- | | |
|---------------------|--------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (Zëvendëskryetare) |
| 3. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaroi fillimin e procedurës për hedhjen e shortit dhe përcaktimin e *anëtarit të Këshillit relator për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datës 21.08.2019.*

Sikurse e parashikon vendimi normativ i KED nr.2/2019, në pikën 29, si edhe për shkak se është vetëm një vend vakant, shorti manual organizohet me një kuti transparente, në të cilën vendosen goglat jotransparente me emrat e anëtarëve të Këshillit. Në këtë shortim përjashtohet anëtarja e Këshillit Fatjona Memçaj për shkak të miratimit të heqjes dorë që nga koha e ardhjes së dokumentacionit të vakancës, nga çdo lloj procedure për këtë vend vakant.

Në fillim vendosen nga punonjësit administrativë në vazo gogla me emrat e anëtarëve të Këshillit Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Margarita Buhali, Arta Marku dhe Eriol Roshi.

Vendosen emrat e anëtarëve të Këshillit në gogla duke ia treguar pjesëmarrëse dhe menjëherë më pas vendosen në vazo.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani urdhëron punonjësin administrativ të tërheqë njërin nga goglat dhe të lexojë me mikrofon emrin e anëtarit të Këshillit.

Punonjësi Administrativ tërheq gogël nga vazo dhe lexon : Vitore Tusha.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe deklaroi se sipas shortit manual relatore për vakancën e parakohshme të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë do të jetë znj. Vitore Tusha.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron mbylljen e procedurës së shortit.

MBYLLET PROCEDURA E SHORTIT

Sekretare

Kryetari

Dorina Dulaj

Ardian Dvorani

Ermelinda Kadiu